ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

# PLANI I PUNËS
# 2013 - 2017

Prishtinë

# Përmbajtja

Shkurtesat 3

Prezantimi i gjendjes aktuale ..... 4

1. HYRJE ..... 7

1.1 Historiku i Planit të punës ..... 7

1.2 Metodologjia dhe burimet e informacionit dhe të dhënave ..... 7

1.3 Struktura e Planit të punës ..... 7

2. GJENDJA AKTUALE ..... 8

2.1 Faktorët e brendshëm ..... 8

2.1.1 Themelimi i ZRRE-së dhe korniza ligjore ..... 8

2.1.2 Misioni dhe Objektivat e ZRRE-së ..... 8

2.1.3 Organizimi ..... 9

2.1.4 Përgjegjësitë e Departamenteve të ZRRE-së ..... 11

2.1.5 Funksionimi i ZRRE-së ..... 11

2.1.6 Burimet njerëzore të ZRRE-së ..... 12

2.1.7 Çështjet financiare ..... 13

2.1.8 Trendet historike të financimit, të hyrat buxheti dhe shpenzimet ..... 13

2.2 Analiza SWOT ..... 14

3. PLANI STRATEGJIK ..... 16

4. PLANET E VEPRIMIT ..... 16

4.1 Plani i veprimit racional ..... 16

4.2 Përmirësimet operative (procedurale) ..... 17

4.3 Zhvillimi i burimeve njerëzore ..... 17

4.4 Avancimi i marrëdhënieve të jashtme ..... 18

4.5 Plani i veprimit të ZRRE-së sipas departamenteve ..... 19

5. PLANI FINANCIAR ..... 34

5.1 Supozimet e përgjithshme ..... 34

5.1.1. Plani i të hyrave ..... 34

5.1.2. Plani i shpenzimeve ..... 34

## Shkurtesat

| | |
|---|---|
| BB | Banka Botërore |
| BE | Bashkimi europian |
| CAPEX | Investimet kapitale |
| DÇT | Departamenti i Çmimeve dhe Tarifave |
| DFEST | Departamenti i furnizimit me energji dhe strukturës së tregut |
| DLL | Departamenti Ligjor dhe i Licencimit |
| DMK | Departamenti i mbrojtjes së konsumatorëve |
| DGET | Departamenti për Gaz dhe Energji Termike |
| KEK | Korporata energjetike e Kosovës |
| KOSTT | Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut i Kosovës |
| LAN | Rrjeti lokal i qasjes |
| MZHE | Ministria e Zhvillimit Ekonomik |
| MiO | Manuali i Operimeve dhe Procedurave |
| MP | Marrëdhëniet me publikun |
| NQ | Ngrohja qendrore |
| OPEX | Shpenzimet operative |
| OSSh | Operator i sistemit të shpërndarjes |
| OST | Operatori i Sistemit të Transmisionit |
| PMC | Procedurat e Menaxhimit të cilësisë |
| SMDI | Sistemi i menaxhimit të dokumenteve dhe informacionit |
| SWOT | Analiza e përparësive, dobësive dhe mundësive |
| TI | Teknologji informative |
| ToR | Termat e referimit |
| USAID | Agjencia e Shteteve të Bashkuara për zhvillim ndërkombëtar |
| ZA | Zyra Administrative |
| ZRRE | Zyra e Rregullatorit për Energji |

# Prezantimi i gjendjes aktuale

- ZRRE-ja është agjensi e cila funksionin e saj e kryen në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës.
- ZRRE-ja ka rol aktiv në zhvillimin, përshtatjen dhe zbatimin e një kornize rregullative të përshtatshme për zhvillimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues të energjisë në Kosovë.
- ZRRE vepron në kuadër të një mjedisi të jashtëm ekonomik, social dhe politik me zhvillim dinamik.
- ZRREështë agjensi e hapur me raporte të mira me institucionet e jashtme.
- ZRRE eshte ne proces te finalizimit teManualit të Operimeve dhe Procedurave.

### *Struktura organizative*

- ZRRE është e organizuar pajtim me ligjeve ne fuqi
- Struktura organizative e ZRRE-së është analitike, dhe siguron pozitë/titull të specifikuar mirë dhe të veçantë për secilin punonjës individualisht.
- Në pajtim me Nenin 5 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Bordi i ZRRE-së duhet të jetë i përbërë nga pesë anëtarë përfshirë kryesuesin, të cilët propozohen nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

### *Burimet njerëzore*

- ZRRE në të gjitha nivelet punëson profesionistë me përvojë, të cilët janë të specializuar në fushat përkatëse.
- Eshte e rendesishme të mbahet niveli i deshirueshëm i cilësisë dhe aftësive të resurseve njerëzore, duke pasur parasysh vështirësinë e tërheqjes dhe punësimit të profileve të nevojshme.
- Ngarkesa aktuale e punës mbulohet me angazhim maksimal të stafit të ZRRE-së. Sidoqofte, ZRRE ka numer te vogel te stafit ne krahasim me vëllimin e punës i cili dukshëm është rritur me ndyshimet e fundit te legjislacionit primar në vitin 2010

### *Sistemet dhe pajisjet*

- I gjithë personeli ka qasje në pajisjet e TI-së në ZRRE.
- ZRRE shfrytëzon Rrjetin lokale të komunikimitLAN d.

### *Çështjet financiare*

- ZRRE-ja është organizatë që nuk realizon profit.
- Të gjitha të dhënat dhe informacioni në lidhje me çështjet financiare të ZRRE-së orientohen drejt prezantimit të rrjedhës së parasë së gatshme.
- Është e rëndësisë esenciale që të sqarohet se Të Hyrat paraqesin paratë e inkasuara, e jo faturat e përgjithshme të lëshuara gjatë kësaj periudhe.

*Faktorët e jashtëm*

- Në sektorin e energjisë elektrike në Kosovë, ekzistojnë ende probleme të shumta infrastrukturore dhe organizative të cilat nuk lejojnë përmbushjen e nevojave të konsumatorëve për sigurimin e furnizimit të vazhdueshëm dhe cilësor me energji elektrike.
- Qeveria e Republikës së Kosovës dhe donatorët kanë ndarë fonde për investime në infrastrukturën energjetike, të cilat kanë dhënë efekte pozitive, por përmirësimet e natyrës esenciale kërkojnë fonde shtesë, të cilat mungojnë.
- Për plotësimin e nevojave të konsumit të energjisë elektrike është e nevojshme të ndërtohen kapacitete të reja gjenerimi, transmisioni dhe shpërndarjeje.
- Paket Projekti Kosove Re  për ndërtimin e një centrali të ri të linjitit dhe për zhvillimin e minierës së Sibovcit është në proces e sipër.
- Punë efektive është bërë në tërheqjen e investitorëve për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë.
- Është bërë shthurja e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit Publik nga KEK-u
- Qeveria e Republikës së Kosovës ka  privatizuar aktivitetet e shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike.
- Në sferën e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, ZRRE-ja ka vazhduar të kryejë detyrimet e saj në përputhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë.
- Sektori i ngrohjes qendrore nuk tregon ndonjë zgjerim të rëndësishëm dhe mbetet ende mjaft i vogël në krahasim me kërkesën e parashikuar për ngrohje në Kosovë, duke mbuluar rreth 5% të nevojave të përgjithshme të ngrohjes.
- Projekti i Koogjenerimit  - Kosova B-NQ Termokos eshte ne fazen e avancuar të realizimit
- Njëri nga objektivat e "Strategjisë së sektorit të energjisë në Kosovë" është që Kosova të lidhet në tubacionet rajonale të gazit , në këtë mënyrë ekzistojnë mundësi serioze për zhvillimin e sektorit të gazit në Kosovë.
- Qeveria ka nisur procedurat për rihartimin e legjislacionit parësor që rregullon sektorin e energjisë, në mënyrë që të jetë në pajtim të plotë me pakon e tretë të legjislacionit (acquis) të BE-së.
- Pakoja e tretë e Energjisë imponon ndryshime të rëndësishme në strukturën e sektorit të energjisë, forcimin e roleve të rregullatorëve dhe OST-ve në të gjithë BE-në, si dhe  koordinimin më të madh në mes tyre.
- ZRRE synon të përfitoi përkrahje nga donatorët e jashtëm (BE, USAID, BB) për zhvillimin e kapaciteteve tësaj

## Parakushtet dhe Supozimet në lidhje me planin financiar

- Në aspektin e gjendjes financiare, ZRRE është agjenci jo-fitimprurëse.
- Pasqyrat financiare, ZRRE i përgatit sipas kërkesave të LMFPP, në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik për raportimin financiar të bazuar në para të gatshme “IPSAS”.
- Të hyrat e ZRRE-së do të jenë afërsisht të barabarta me Buxhetin e aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

### *Plani i financimit*

- Sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë 03/L-185, taksat e inkasuara nga ZRRE në lidhje me licencimin dhe aktivitetet tjera, në bazë të nenit 22 të këtij ligji, do të jenë të hyra të dedikuara të ZRRE-së. Veç kësaj, ZRRE, për qëllime të kryerjes së përgjegjësive të saj sipas ligjit, mund të shfrytëzojë ndarje buxhetore.
- Menaxhimi i brendshëm financiar i ZRREbëhet në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
- Donacionet mbulojnë kostot e asistencës teknike për ngritjen e kapaciteteve të ZRRE-së.

### *Plani i të hyrave*

- Të hyrat vijnë në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Kapitulli 4 nga taksat e inkasuara nga të licencuarit, duke i mundësuar ZRRE-së në këtë mënyrë që të veprojë si organ rregullator i pavarur financiarisht.
- Është esenciale të sqarojmë se në bazë të standardeve ndërkombëtare te kontabilitetit te sektorit publik të bazuar në para të gatshme "IPSAS", Të hyrat paraqesin paratë e inkasuara gjatë periudhës dhe jo totalin e faturave të lëshuara gjatë periudhës.
- Taksat vjetore të licencimit formojnë pjesën më të madhe të të hyrave të ZRRE-së.
- Një pjesë e konsiderueshme e shumave të faturuara nuk inkasohet brenda vitit fiskal në të cilin janë faturuar.

### *Shpenzimet operative*

- Shpenzimet operative përbëhen nga: a) shpenzimet për paga dhe mëditje, b) shpenzimet për mallra dhe shërbime dhe c) shpenzimet e shërbimeve komunale.
- Pagat dhe mëditjet varen nga vendimet për buxhetin e aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe vendimet e Bordit të ZRRE-së.
- Shpenzimet për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve varen nga kërkesat e ZRRE-së për këto destinime, si dhe nga buxheti i aprovuar për këtë kategori.

### *Investimet kapitale*

- Investimet kapitale të buxhetuara i nënshtrohen miratimit nga Kuvendi i Kosovës për projektet e propozuara nga ZRRE.
- Zhvlerësimi i aseteve fikse të ZRRE-së bëhet nga Ministria e Financave - Departamenti i Thesarit.

# 1. HYRJE

## 1.1 Historiku i Planit të punës

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) është themeluar në vitin 2004 në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë. ZRRE luan një rol të rëndësishëm në rregullimin, shthuarjen dhe monitorimin e sektorit të energjisë në Kosovë, në lëshimin e licencave, përcaktimin e tarifave për ndërmarrjet e rregulluara të energjisë, funksionimin e një tregu të hapur dhe konkurrues, dhe në rregullimin e kompanive të energjisë që mund të karakterizohen si monopole.

ZRRE përgatit buxhetin vjetor dhe Raportin Vjetor të cilat i dërgon për shqyrtim dhe aprovim në Kuvendin e Kosovës.

## 1.2 Metodologjia dhe burimet e informacionit dhe të dhënave

Plani i punës është përpiluar përmes:

- Mbledhjes se të dhënave
- Konfirmimit të strategjisë dhe caqeve strategjike.
- Përditësimit dhe zhvillimit të Planeve të veprimit.
- Hartimit të Planit financiar dhe Planit të zbatimit.

Përveç kësaj për përgatitjen e Planit të punës, janë përdorur edhe këto burime të brendshme të informacionit:

- Plani i punës i ZRRE-së 2005-2009.
- Plani i punës i ZRRE-së 2010-2012.
- Raportet vjetore të ZRRE-së (2004 - 2011).
- Buxhetet financiare të ZRRE-së.

## 1.3 Struktura e Planit të punës

Plani i punës i ZRRE-së 2013-2017 përbëhet nga këto komponente kryesore:

- Prezantimi dhe vlerësimi i gjendjes aktuale;
- Plani strategjik;
- Plani i veprimit;
- Plani financiar, dhe
- Plani i zbatimit.

Objektivi kryesor i Planit të punës është që t'i sigurojë ZRRE-së një instrument efikas për të planifikuar në perspektivë. Plani i punës do të jetë për një periudhë pesë vjeçare (2013-2017).

Në përgjithësi, pritjet financiare në një plan të punës nuk janë drejtpërdrejt të krahasueshme ose të përputhshme me buxhetet përkatëse financiare të organizatave.

# 2. GJENDJA AKTUALE

Vlerësimi i gjendjes aktuale të ZRRE-së përfshin një analizë të shkurtër të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm , nxjerrjen e konkluzioneve  dhe kryerjen e një SWOT analize përkatëse.

Objektivi është që të krijojë bazën einformacionit, i cili është i nevojshëm për planifikimin strategjik.

## 2.1 Faktorët e brendshëm

### 2.1.1 Themelimi i ZRRE-së dhe korniza ligjore

ZRRE-ja është themeluar me Ligjin Nr. 2004/9 për Rregullatorin e Energjisë, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 29 prill 2004. Ky ligj u ndryshua me Ligjin Nr.03/L-080 për ndryshimin e Ligjit të Kuvendit të Kosovës Nr.2004/9 për Rregullatorin e Energjisë, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 13 qershor 2008.
Me 01 dhjetor 2010 ka hyrë në fuqi Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185), i cili është amendamentuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Po në të njëjtën kohë janë amendamentuar edhe Ligji për Energjinë (Ligji Nr. 03/L-184) dhe Ligji për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 03/L-201).

Pas hyrjes në fuqi të këtyre ligjeve, ZRRE ka harmonizuar  të gjithë legjislacionin sekondar të saj në pajtim me ligjet në fuqi.

### 2.1.2 Misioni dhe Objektivat e ZRRE-së

#### Misioni

Misioni i ZRRE-së është që të krijojë një treg të qëndrueshëm të energjisë në Kosovë të bazuar në parimet e transparencës dhe konkurrencës së lirë, e cila shton vlerat si për konsumatorët ashtu dhe për ndërmarrjet.

Objektivat e ZRRE-së përcaktohen me Nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe janë:

- të hartojë rregulla, procedura dhe metodologji për krijimin dhe funksionimin e konkurrencës mbi tregun e energjisë, përfshirë kushtet e qasjes së palëve;
- të hartojë metodologjië tarifore për furnizimin e energjisë me tarifa të rregulluara;
- të zhvillojë sisteme për monitorimin e cilësisë së shërbimeve dhe pajtueshmërisë nga të licencuarit; dhe
- të imponojë zbatimin dhe përputhshmërinë e të licencuarit me rregullat, procedurat dhe metodologjitë e mësipërme dhe të veprojë si faktor balancues në mes të akterëve të tregut.

Përgjegjësitë të ZRRE-së ushtrohen me anë të:

- lëshimit të licencave dhe monitorimit të aktiviteteve të energjisë;
- lëshimit të autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, rrjeteve të gazit, linjave direkte të energjisë elektrike dhe linjave direkte të tubacioneve;
- miratimit të metodologjisë së tarifave dhe çmimeve për aktivitetet që nuk janë pjesë e një tregu konkurrues;
- miratimit të legjislacionit dytësor që rregullon sektorin e energjisë;
- monitorimit të shthurjes efektive dhe zhvillimit të konkurrencës në sektorin e energjisë, dhe
- zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë.

Me qëllim të përmbushjes së rolit dhe objektivave të saj ZRRE ka autoritetin për të:

- dhënë, modifikuar, suspenduar, transferuar, tërhequr, mbikëqyrë dhe kontrolluar përputhshmërinë me Licencat;
- caktuar parimet dhe metodologjitë e çmimeve, pastaj për të miratuar tarifat për shërbimet e rregulluara të energjisë (qasjen dhe shfrytëzimin e rrjeteve, furnizimin publik, detyrimet e shërbimit publik etj.);
- fillojë procedurat e tenderimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese në rast se procesi i autorizimit nuk ofron kapacitet të mjaftueshëm dhe në rast se kërcënohet siguria e furnizimit;
- monitorojë shpërbërjen e formës ligjore, organizimit, vendim-marrjes dhe llogarive të ndërmarrjeve të energjisë. Këtë rol ZRrE-ja do ta kryejë përmes lëshimit të licencave për aktivitetet e shpërbëra të ndërmarrjeve të energjisë, aprovimit të tarifave dhe aktiviteteve të ngjashme brenda fushëveprimit të ZRRE-së. Funksioni i monitorimit mbulon gjithashtu monitorimin e tarifave, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, cilësinë e shërbimeve, standardet e performancës etj.;
- rishikojë, miratojë dhe kontrollojë përputhshmërinë me të gjitha kodet dhe rregullat teknike, duke përfshirë rregullat e rrjetit, shpërndarjes, matjes, kyçjes dhe shfrytëzimit të sistemit dhe rregullat e tregtisë; të vendosë rregullat për qasje në linjat-nyje dhe linjat ndërkombëtare të tubacionit si dhe menaxhimin e kongjestioneve në to;
- nxjerrë akte të përgjithshme, akte individuale, dhe legjislacionin sekondar dhe të zbatojë dispozitat e Ligjeve dhe legjislacionit tjetër të ndërlidhur dhe të vendosë gjoba për shkeljet.

### 2.1.3 Organizimi

ZRRE-ja është e organizuar në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Kreu II i Ligjit) dhe Rregullën për Organizimin dhe Funksionimin e ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së sipas përgjegjësive të përcaktuara me ligj kryen aktivitete si në vijim:

- miraton politikat rregullative dhe operacionale të ZRRE;
- organizon dhe mbikëqyr punën e ZRRE ;
- mbikëqyr zbatimin e buxhetit dhe menaxhimin financiar të ZRRE dhe miraton raportet dhe deklaratat financiare të saj;
- organizon punësimin, emëron dhe mbikëqyrë punën e personelit të punësuar nga ZRRE;
- miraton nivelet e kompensimit dhe kushtet tjera të punësimit, për të punësuarit e ZRRE;
- merr vendime dhe nxjerr rregulla dhe akte tjera nënligjore të përgatitura nga ZRRE, në pajtim me ligjin.

Struktura bazë përbëhet nga pesë departamente dhe Zyra Administrative (ZA). Departamentet janë themeluar në pajtim me detyrat operacionale të ZRRE-së. Pesë departamentet janë:

- Departamenti Ligjor dhe i Licencimit (DLL),
- Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve (DMK),
- Departamenti për Treg të Energjisë (DTE)
- Departamenti për Çmime dhe Tarifa (DCT), dhe
- Departamenti për Gaz dhe Energji Termike (DGET).

Skema organizative e ZRRE-së e aprovuar në vitin 2012:




*DTE – Departamenti për Treg të Energjisë*

*DMK – Departamenti për mbrojtje të konsumatorëve*

*DLL – Departamenti ligjor dhe i licencimit*

*DTÇ – Departamenti për  tarifa dhe çmime*

*DGET- Departamenti për Gaz dhe Energji Termike*

*NjA- Njësia e Administratës*

### 2.1.4 Përgjegjësitë e Departamenteve të ZRRE-së

Departamenti ligjor dhe i licencimit

Departamenti ligjor dhe i licencimit është përgjegjës për hartimin e legjislacionit dytësor dhe akteve nënligjore, vlerësimin e aplikacioneve për licencim të ndërmarrjeve të energjisë, vlerësimin e aplikacioneve për dhënien e autorizimeve për ndërtim të kapaciteteve të reja. Ky departament gjithashtu bënë mbikëqyrjen dhe monitorimin e aktiviteteve të të licencuarve.

Departamenti i tregut të energjisë

Departamenti i tregut të energjisë është përgjegjës për strukturën e tregut, monitorimin përformancës së pjesëmarrësve të tregut, vlerësimin dhe analizën e të dhënave në sektorin e energjisë. Departamenti gjithashtu monitoron konkurrencën dhe sjelljen e pjesëmarrësve në treg në principet e objektivitetit, transparencës dhe jo-diskriminimit.

Departamenti i tarifave dhe çmimeve

Departamenti i tarifave dhe çmimeve është përgjegjës për vlerësimin e aplikacioneve tarifore të ndërmarrjeve të licencuara dhe i prezanton ato te Bordi për aprovim; monitoron realizimin e shpenzimeve operative dhe kapitale përmes Shqyrtimeve Tarifore; ndërmerr të gjitha masat që tarifat të jenë kost - reflektive, të arsyeshme, jo-diskriminuese, të bazuara në kritere objektive, si dhe të vendosura në mënyrë transparente duke marrë në konsideratë që përcaktimi i tarifave të mos dëmtojë konsumatorët.

Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve

Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve është përgjegjës për shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve ndërmjet konsumatorëve dhe ndërmarrjeve për energji, operatorëve të sistemit dhe ndërmarrjeve energjetike, si dhe ndërmjet dy ndërmarrjeve energjetike. Gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive, ky departament bashkëpunon me të gjitha institucionet dhe organizatat të cilat në mënyrë legjitime i përfaqësojnë konsumatorët.

Departamenti për energji termike dhe gaz natyror

Departamenti për energji termike dhe gaz natyror është përgjegjës për shqyrtimin dhe implementimin e strategjive, ligjeve standardeve të performancës dhe praktikave tjera operacionale që kanë të bëjnë me këta sektorë. Gjithashtu zhvillon sistemet për raportim të ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore duke u fokusuar në elementet tekniko-teknologjike dhe në integrimin e masave nxitëse dhe caqeve për efiçiencë., si dhe kryen monitorimin e të licencuarve..

Njësia e administratës

Njësia e administratës mbështet funksionimin e ZRRE-së, organizon rekrutimin efikas të stafit të ZRRE-së, koordinon trajnimet e stafit të ZRRE-së, furnizimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës dhe ndihmon në rregullimin e zyrës duke e bërë atë të përshtatshme për punë për të gjithë stafin e ZRRE-së.

### 2.1.5 Funksionimi i ZRRE-së

Përshkrimet e punës hartohen në mënyrë analitike për personelin e ZRRE-së. Këto përshkrime të punës janë zhvilluar në mënyrë të detajuar dhe individualisht sipas pozitës organizative dhe janë publikuar për secilën pozitë operative në organizatë, në formën e Termave të Referencës (ToR).

Sa i përket sistemeve, ZRRE-ja përdor rrjet lokal të qasjes (LAN) dhe i gjithë personeli janë të lidhur me sistemin e kompjuterëve. Gjithashtu ekziston qasje e vazhdueshme në shërbimet e internetit dhe korrespondencës elektronike. Nevojat e rëndësishme të ZRRE-së që duhet të mbështeten nga një sistem

kompetent i menaxhimit të dokumenteve dhe informacionit, janë të njohura dhe tashmë është prokuruar një projekt në lidhje me këtë.

Kontrolli i brendshëm brenda ZRRE-së realizohet aktualisht nga menaxhmenti dhe stafi i ZRRE-së.

### 2.1.6 Burimet njerëzore të ZRRE-së

ZRRE-ja është organizatë me numër të përgjithshëm prej 33 pozitash, duke përfshirë anëtarët e Bordit. Aktualisht, janë të punësuar 28 punonjës. Madhësia e organizatës imponon domosdoshmërinë që të jetë fleksibile dhe në të njëjtën kohë, të përdorë në masë sa më të madhe burimet (njerëzore, financiare, teknike) të organizatës.

Struktura organizative është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

**Pozitat e tanishme organizative**

| Pozitat organizative | Pozitat | Punësimi | Vendet e lira (përshkrimi) |
|---|---|---|---|
| **Bordi i ZRRE-së** | 5 | 5 | |
| **Zyrtar për Marrëdhënie me Publik** | 1 | 1 | |
| **Departamenti Ligjor dhe i Licencimit** (DLL)<br>* Udhëheqës i departamentit<br>* Ekspert për Çështje Ligjore & Monitorim<br>* Analisti i monitorimit të licencave<br>* Zyrtari Ligjor & Licencimit | 4 | 3 | * Ekspert për Çështje Ligjore & Monitorim |
| **Departamenti i mbrojtjes së konsumatorit** (DMK)<br>*Udhëheqësi departamentit<br>* Analist për përmbushje të standardeve<br>* Zyrtari i kujdesit për konsumatorë | 3 | 3 | |
| **Departamenti i Tregut të Energjisë** (DTE)<br>*Udhëheqës i departamentit<br>* Ekspert për Centrale Elektike<br>* Analist për Sisteme Energjetike<br>*Analist për Monitorim të Tregut<br>* Analist për furnizim me energji dhe Strukturë të Tregut | 5 | 4 | |
| **Departamenti i Çmimeve dhe Tarifave** (DÇT)<br>* Udhëheqës i departamentit<br>* Ekspert për Çështje Rregullative dhe Tarifa<br>* Zyrtar për Ekonomi<br>* Analist për strukturë tarifore | 4 | 4 | |

| Pozitat organizative | Pozitat | Punësimi | Vendet e lira (përshkrimi) |
|---|---|---|---|
| **Zyra administrative (ZA)**<br>* Udhëheqës i Zyres Administrative<br>* Zyrtar Kryesor Financiar<br>* Menaxher i prokurimit<br>* Zyrtar i Administratës<br>*Zyrtar për Menaxhimin e të Dhënave<br>* Zyrtar për Asistencë të Bordit<br>* Përkthyes i gjuhën angleze<br>* Përkthyes i gjuhës serbe<br>* Vozitës/Mirëmbajtës | 9 | 6 | * zyrtar për asistencë të Bordit<br>*Përkthyes i gjuhës angleze<br>*Përkthyes i gjuhës serbe |
| **Departamenti për Gaz dhe Energji Termike (DGET)**<br>* Udhëheqës i departamentit<br>* Analist për Energji Termike | 2 | 2 | |
| **TOTAL** | **33** | **28** | **4** |

### 2.1.7 Çështjet financiare

Të gjitha të dhënat dhe informacionet në lidhje me financat e ZRRE-së janë të orientuara drejt prezantimit të aspektit të rrjedhës së parasë në vend të rezultateve financiare. Prej vitit 2006 ZRRE ka filluar të gjenerojë të hyra nga taksat e licencave në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Kapitulli 4, si tarifa të inkasuara nga të licencuarit, duke i mundësuar në këtë mënyrë ZRRE-së që të veprojë si organizëm rregullator i pavarur financiarisht.

### 2.1.8 Trendet historike të financimit, të hyrat buxheti dhe shpenzimet

Të Hyrat

| | 2010 | 2011 | 2012 |
|---|---|---|---|
| Të hyrat e mbledhura gjatë vitit | 555,142 | 508,690 | 589,556 |
| Të hyrat e bartura nga viti paraprak | 411,929 | 205,213 | 109,279 |
| **Gjithësej Të hyrat** | **962,072** | **713,903** | **698,835** |

Zbritja e nivelit tetë hyrave nga viti 2010 e tutje eshte bere me qëllim të barazimit të të hyrave me buxhetin e aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Buxheti

| | 2010 | 2011 | 2012 |
|---|---|---|---|
| **Buxheti** | 856,966 | 675,456 | 678,456 |

Shpenzimet

| | 2010 | 2011 | 2012 |
|---|---|---|---|
| **Shpenzimet** | 651,753 | 604,624 | 643,502 |

Shpenzimet vjetore sipas kategorive ekonomike

| Përshkrimi | 2010 | 2011 | 2012 |
|---|---|---|---|
| Pagat dhe mëditjet | 332,681.19 | 368,081.76 | 372,319.46 |
| Mallrat dhe shërbimet | 187,010.92 | 187,775.68 | 219,893.29 |
| Shpenzimet komunale | 8,271.48 | 8,747.35 | 10,158.56 |
| Shpenzimet kapitale | 123,789.63 | 40,018.73 | 41,130.36 |
| **TOTALI** | **651,753.22** | **604,623.52** | **643,501.67** |

## 2.2 Analiza SWOT

Analiza SWOT (e përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve), kryhet duke përdorur konkluzionet e nxjerra nga analiza dhe vlerësimi i mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm të ZRRE-së.

Qëllimi i kësaj analize është që të konstatoj aspektet e rëndësishme të gjendjes aktuale, d.m.th. aftësinë e ZRRE-së për të përmbushur nevojat, duke marrë parasysh edhe faktorët e brendshëm (përparësitë, dobësitë) dhe ata të jashtëm (mundësitë, rreziqet), në mënyrë që të arrijë në konkluzione të realizueshme.

Analiza arrihet duke iu përgjigjur pyetjeve të një rëndësie të madhe, si:

Pikat e forta:

- Cilat janë përparësitë e ZRRE-së?
- Çfarë është duke arritur ZRRE-ja?
- Cilat janë pikat e forta të ZRRE-së sipas stafit?

Pikat e dobëta:

- Në çfarë gjërash nuk qëndron ZRRE-ja mirë?
- Cilat çështje do të mund të përmirësoheshin?
- Cilat janë pikat e dobëta të ZRRE-së sipas stafit të saj?

Mundësitë:

- Cilat janë mundësitë e parapara të ZRRE-së për t'i bërë gjërat më mirë?
- Cilat janë trendet dhe zhvillimet e mundshme që ZRRE-ja mund të përdorë apo nga të cilat mund të përfitojë?

Kërcënimet:

- A ka ndonjë zhvillim të pritshëm që mund të ndikojë negativisht në performancën e ZRRE-së?
- Cilat janë pengesat kryesore të ZRRE-së për arritjen e objektivave të saj?
- A i bëhet ZRRE-së trysni nga mjedisi i jashtëm lokal apo ndërkombëtar?

Në mënyrë që analiza të aplikohet në mënyrë të suksesshme duhet:

  - T'i qaset procesit në mënyrë objektive dhe të bëhen përpjekje për të gjykuar çështjet nga perspektiva e një të jashtmi.

- Të identifikohet ndikimi relativ i faktorëve të ndryshëm në mënyrë që të arrihet në konkluzione të besueshme.

Analiza SWOT është shtytësi kryesor që duhet të përdoret për formatizimin e strategjisë së ZRRE-së, e cila ka për cak shfrytëzimin e pikave të forta, minimizimin apo evitimin e pikave të dobëta, përfitimin nga mundësitë dhe shmangien e kërcënimeve.

Analiza SWOT, sipas qasjes së përbashkët, jepet në një format standard në një faqe të vetme, si më poshtë:

| PIKAT E FORTA | PIKAT E DOBËTA |
|---|---|
| • ZRRE-ja ka rol aktiv në tregun e energjisë në Kosovë<br>• Përshkrimet e punës janë të plota, analitike dhe kuptohen nga stafi<br>• ZRRE ka pasë mbështetje teknike për ngritjen e kapaciteteve<br>• Në të gjitha nivelet, ZRRE-ja punëson profesionistë të aftë dhe me përvojë, të cilët posedojnë njohuri të specializuara<br>• ZRRE-ja bashkëpunon me efikasitet me rregullatorët e tjerë të energjisë dhe merr pjesë në forumet ndërkombëtare | • ZRRE-ja është agjenci relativisht e re, ende në fazën e zhvillimit<br>• Niveli i cilësisë dhe aftësisë së burimeve njerëzore të ZRRE-së nuk është e lehtë të mbahet<br>• |
| **MUNDËSITË** | **KËRCËNIMET** |
| • Ekziston përvojë e konsiderueshme sa i përket rregullimit të energjisë. ZRRE-ja mund përmirësojë më tej bashkëpunimin e saj aktiv me rregullatorët e tjerë të energjisë dhe pjesëmarrjen e saj në forumet ndërkombëtare.<br>• Zhvillimi i sektorit të energjisë (në përgjithësi) do të ndikoj në imazhin dhe statusin e ZRRE-së.<br>• Përfshirja e gazit natyror në Kosovë, përdorimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe përmirësimi i ngrohjes qendrore do ta forcojë pozitën e ZRRE-së.<br>• Përfshirja e Pakos së tretë të energjisë në legjislacionin parësor do ta forcojë pozitën e ZRRE-së. | • ZRRE-ja është duke operuar në një mjedis të jashtëm që ndryshon shpejt.<br>• ZRRE-ja nuk mund të ndikojë në mënyrë efektive në vendimet që merren nga Kuvendi apo qeveria e Kosovës.<br>• Problemet infrastrukturore në sektorin e energjisë, mund të ndikojnë negativisht në imazhin e ZRRE-së.<br>• Pavarësia e ZRRE-së nuk mund të garantohet vetëm me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.<br>Pamundësia e zbatimit të plotë të pavarësë financiare |

# 3. PLANI STRATEGJIK

ZRRE në planin strategjikë bazohet në Strategjinë e Energjisë, si dhe qasjen sistematike që synon të përkufizojë një orientim afatgjatë, të qartë dhe në kontinuitet të agjencisë, në mënyrë që ajo ta kryejë rolin e saj dhe të arrijë misionin e saj. Plani strategjik përdoret edhe si një mjet efektiv për shkëmbimin e përvojave në ambientin e përgjithshëm të ZRRE-së.

Caqet strategjike rezultojnë nga:

a) përcaktimi i drejtimeve themelore të punës dhe caqeve të ZRRE-së dhe

b) përkufizimi i caqeve të rëndësishme strategjike.

Orientimi për arritjen e caqeve strategjike është nxitësi kryesor për zhvillimin e planeve të veprimit të punës. Respektivisht, plani i punës paraqet një qasje dhe veprime të detajuara me qëllim të arritjes së caqeve strategjike të agjencisë. Ekzistojnë disa dallime të mëdha në mes të planit strategjik dhe planit të punës.

Si rregull:

| *Plani strategjik* është: | *Plani i punës* është: |
|---|---|
| Afatgjatë | Afatmesëm |
| I shkurtër dhe konciz | Analitik |
| Kualitativ | Kuantitativ |

Strategjia e ZRRE-së orientohet drejt arritjes së qëllimeve të agjencisë.

# 4. PLANET E VEPRIMIT

Përcaktimi i politikave drejt zbatimit të strategjisë së agjencisë dhe arritjes së caqeve strategjike përfshin lidhjen e ndërthurur në mes të planifikimit strategjik dhe planifikimit të punës. Kjo arrihet me hartimin e Planeve të Veprimit, të cilat janë një komponent bazë i planifikimit të punës dhe i referohen zhvillimit analitik të një serie veprimesh të planifikuara, që synojnë:

- përshkrimin e objektivit dhe caqeve të Planit të Veprimit;
- arritjen e caqeve të punës;
- rezultatet e pritshme;
- përshkrimin e veprimeve të domosdoshme;
- caktimin e veprimeve;
- ndërlidhjet në mes të veprimeve (nëse janë të aplikueshme);
- afatin kohor; dhe
- koston e veprimeve - burimeve (njerëzore, teknike dhe financiare) të nevojshme.

## 4.1 Plani i veprimit racional

Analiza dhe vlerësimi i situatës aktuale kanë përcaktuar një kuadër të problemeve të paraqitura tashmë në kapitujt përkatës. Këto probleme paraqesin fushat për ndërhyrje të mundshme në të ardhmen, që synojnë përmirësimin e efektivitetit dhe efikasitetit të ZRRE-së dhe arritjen e objektivave të saj strategjike.

## 4.2 Përmirësimet operative (procedurale)

### Përmirësimi i komunikimit të brendshëm:

Përveç Planit të Veprimit, menaxhimi i përditshëm duhet të marrë hapat e nevojshëm për:

- Ngritjen e nivelit të bashkëpunimit formal dhe joformal në mes të departamenteve;
- kultivimin dhe mbështetjen e konceptit të shkëmbimit të informacionit;
- krijimin dhe përdorimin e listave për dërgimin e emailave (postimeve) për kategori të ndryshme të dokumenteve apo ngjarjeve;
- rritjen e numrit të mbledhjeve të personelit në mënyrë të rregullt;
- mbajtjen e takimeve të shkurtra;
- fokusimin në mënyrë ekskluzive në çështjet profesionale dhe operacionale.

### Zhvillimin e Planit të punës dhe rishikimet vjetore:

Zhvillimi dhe rishikimi i Planit të punës nuk janë paraparë si objektiva dhe procedura të veçanta organizative. Megjithatë, është e nevojshme që këto detyra të përmbushen së brendshmi në ZRRE.

### Veprimet që synojnë marrjen e certifikatës PMC:

Për çdo organizatë, përfitimet e pritura nga marrja e certifikatës së Menaxhimit të Cilësisë, si p.sh. certifikata e njohur ndërkombëtarisht ISO 9001 e cila prinë botërisht dhe është e pranuar unanimisht në standardet e menaxhimit të cilësisë dhe në këtë mënyrë rezulton të jetë një cak i qartë për ZRRE-në, janë të konsiderueshme.

Mungesa e procedurave të regjistruara dhe të aplikuara është një element i madh pengues për arritjen e menaxhimit të cilësisë dhe marrjen e certifikatës përkatëse PMC. Aplikimi për një certifikatë PMC, p.sh. si ISO 9001, duhet të pasojë krijimin e një mjedisi të brendshëm të kontrollueshëm.

### Veprimet që synojnë përmirësimin e kontrollit të brendshëm:

Një mjedis i brendshëm i kontrollueshëm është një parakusht thelbësor për një operim të qëndrueshëm të ZRRE-së. Kontrolli i brendshëm aktualisht realizohet nga menaxhmenti dhe stafi i ZRRE-së.

Përveç miratimit dhe zbatimit të MiO-s, amandamentimi i legjislacionit që ka të bëj me kontrollin e brendshëm do të nxisë më tej përmirësimin e funksionimit të brendshëm të ZRRE-së.

## 4.3 Zhvillimi i burimeve njerëzore

### Ngarkesa e punës dhe mjaftueshmëria e personelit:

Në përgjithësi, ngarkesa e punës vazhdon të mbetet e lartë, me ngritje të herëpashershme të aktiviteteve të shtuara rregullatore ose mungesës së personelit. Ky problem mund të zgjidhet duke kombinuar plotësimin e vendeve të lira dhe zbatimin e Planit të veprimit për përmirësime organizative (strukturore).

### Nevojat e trajnimit:

Sa i përket nevojave të trajnimit, ato mund të identifikohen nga Departamentet. Nevojat e trajnimit duhet të kenë për cak fusha shumë të specializuara.

Nevojat e planifikuara të trajnimit duhet të verifikohen në lidhje me përshkrimin e objektivave të tyre. E ndërlidhur me trajnimin është çështja e transferimit të njohurive. Është shumë e rëndësishme që personeli më i vjetër të kalojë njohuritë e tyre, sidomos ato të fituara gjatë trajnimit profesional, te stafi i ri, duke minimizuar rrezikun që ZRRE-ja të humbë tërësisht njohuritë dhe ekspertizën në momentin që një individ i tillë largohet.

## 4.4 Avancimi i marrëdhënieve të jashtme

### Strategjia e Marrëdhënieve me Publikun:

Marrëdhëniet me publikun dhe transparenca janë të një rëndësie të veqantë për ZRRE-në. Kjo është e kërkesë e legjislacionit në fuqi.

Duke pasur parasysh objektivat e Planit të punës, me qëllim të përmirësimit të marrëdhënieve të jashtme, ZRRE planifikon finalizimin dhe miratimin Strategjisë së Marrëdhënieve me publikun.

### Zbatimi i strategjisë së miratuar të MP-së:

ZRRE-ja është duke planifikuar që të realizojë gradualisht hapa të zbatueshëm praktikë për avansimin e relacioneve me publikun. Në veçanti, ZRRE-ja a) do të marrë masa për mbledhjen dhe rishqyrtimin e të gjitha rregullave, parimeve dhe procedurave përkatëse (duke përfshirë disa tema të caktuara, të cilat janë të përfshira në MiO), b) do të miratojë dhe të zhvillojë më tej strategjinë e komunikimit të jashtëm, c) do të zhvillojë një Plan të përgjithshëm të komunikimit të jashtëm, d) do të forcojë aktivitetet për marrëdhënie me publikun dhe kontaktet me media në përputhje me strategjinë, dhe e) do të mbajë kontakte të rregullta me organizata ndërkombëtare.

### Zhvillimi i planit të veprimit rreth komunikimeve:

Zhvillimi i nevojshëm i një plani të veprimit rreth komunikimeve është një përpjekje për të përfshirë ZRRE-në në praktikën e zbatimit të strategjisë së marrëdhënieve me publikun. Personelit që do t'i caktohet kjo detyrë duhet të përshtasë metodologjinë sa herë që gjykohet e nevojshme, në bazë të situatave dhe çështjeve specifike që ballafaqohet organizata si dhe burimeve njerëzore dhe financiare në dispozicion.

Sfidat që duhet të përballen janë a) të sigurohet që mesazhi i duhur t'i dorëzohet marrësit të duhur në kohën e duhur nëpërmjet mjetit të duhur, b) të koordinojë konsistencën e mesazheve, strategjive dhe shfrytëzimit të burimeve në të gjithë organizatën c) të menaxhojë dhe prioritizojë secilin grup të interesuarish, të cilët kanë nevoja të ndryshme të komunikimit, d) të sigurojë që vendimet e ndërlidhura me komunikimin të bëhen në mënyrë proaktive dhe me shqyrtimin e duhur të menaxhmentit, dhe e) të krijojë një përshtypje të favorshme për ZRRE-në në realitetin e jashtëm.

Përpjekja për t'iu përgjigjur këtyre problemeve dhe çfarëdo nisme që synon nxjerrjen e përfitimeve nga mundësitë, ka rezultuar me hartimin e Planeve të veprimit si vijon:

*4.5 Plani i veprimit të ZRRE-së sipas departamenteve*

| DEPARTAMENTI I TREGUT TË ENERGJISË | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Qëllimi** | **Objektivat** | **Projektet/aktivitetet** | **Indikatorët kyç/Rezultatet** | **Koha tentative e kryerjes** |
| Dizajni i Tregut Rregullat e Tregut | Finalizimi dhe përgatitja për aprovim i dizajnit të Tregut | Pjesëmarrje gjatë zhvillimit, komentim i dokumentit, dhe përgatitje për aprovim nga Bordi i ZRRE-së. | Aprovimi i dokumentit | 2013 |
